



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM – ERZEN “TIRANË”

Nr. 5432 prot
13

Tiranë më 27.12.2017

VENDIM

Nr. 6 datë 14.12.2017

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR PAJISJE ME LEJE PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR, PËR AMBALLAZHIM SHISHE OSE ENË, NË BURIMIN GURRA E MILAJT, FSHATI SHËNGJIN , BASHKIA TIRANË SUBJEKTI “AISHE LUZI”.

Në zbatim të ligjit Nr.111/2012 datë 15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" Përkatësisht neni 41, pika 1, gërma “d”; dhe neni 50 pika 2; Vendimit Nr. 416, datë 13.5.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”, Vendimit nr.5 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor” neni 16 gërma ç, Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016 “Për miratimin e rregullores”, “Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor” neni 13 pika 1, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

KONSTATOI SE :

Në mbledhjen e datës 14.12.2017 në praninë e anëtarëve :

1. Gimjan Dokle
2. Fiqiri Borici
3. Ilmi Gjeci
4. Eleonora Shqina
5. Eneida Kalaci
6. Tomorr Kotarja
7. Ilir Vishkurti
8. Lorenc Facja
9. Hysni Mara
10. Alket Kumaraku
11. Klodian Laska
12. Fatjona Levanaj

13. Haxhire Gërmajsi

14. Aida Nani

Shqyrtoi kërkesën e subjektit Aishe Luzi për miratimin e kërkesës për pajisje me leje përdorimi të burimit ujqor nëntokësor për amballazhim shishe ose enë, në burimin “Gurra e Milajt”, me vendodhje fshati Shëngjin, bashkia Tiranë me këto të dhëna:

Kooridnatat X= 44 21 510 Y=45 75 410 Z= 728 m

- | | |
|------------------------------------|--------------------------------|
| a. Prurja mesatare e vjetore | 0.005 m ³ /s (5l/s) |
| b. Sasia e ujit që kërkohet | 0.005 m ³ /s |
| c. Rrjedha ekologjike | 0.0015 m ³ /s |
| ç. Sasia e që do jepet në përdorim | 0.005 m ³ /s (5l/s) |

Nga shqyrtimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës rezultoi se për dhënien e lejes për përdorimin e këtij burimi ujqor të merren masa nga subjekti për poltësimin e kushteve të mëposhtme:

- Të merret opinioni i UKT-së për prioritetin e ujit të pijshëm për këtë burim ujqor.
- Të merret opinioni i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.
- Përsëritjen e analizave për ujin e pijshëm.
- Heqja nga fondi pyjqor.

Për këto arsye në mbështetje të gërmës “ç”, neni 16 të vendimit nr.5 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujqor”, Këshilli i Basenit Ujqor,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e propozimit të kërkesës për pajisje me leje përdorimi të burimit ujqor nëntokësor për amballazhim shishe ose enë, në burimin “Gurra e Milajt”, për subjektin “Aishe Luzi”, vendodhja fshati Shëngjin, bashkia Tiranë.
2. Ngarkohet ABU Ishëm Erzen për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR

Shpëtim MEDIU



KRYETAR

Suzana JAHOLLARI

